



PROCESVERBALI

-III. Nr. i prot. 2047 Më 28.06.2019
Br. prot. _____ Dt. _____
RAHOVEC - ORAHOVAC

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **31.05.2019** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. **Smajl Latifi**, nënkyetar i komunës z. **Fatmir Iska**, drejtor të drejtive komunale, pjesëtar të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, gazetarë dhe media, dh ju kuvendarë të nderuar. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave dhe KAB-it 2020-2022,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dalje në debat publik të Draft Rregullores Komunale për Transparencë,
5. Shqyrtimi i Informatës mbi Raportin e Performancës komunale janar – dhjetor -2018.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikave të rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës për këtë mbledhje: Konstatoj se unanimisht është aprovuar Rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të jepe ndonjë vërejte apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim Procesverbalit nga mbledhja e kaluar: **Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar** pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e 2 të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, ne gjithmonë kemi thënë se si prioritet i kemi çështjet e kanalizimeve dhe shumë çështje tjera. E kam një kërkesë nga disa familje të fshatit Celinë, këtyre familjeve nuk ju është kryer rrjeti i kanalizimit nëpër shtëpitë e tyre, kemi të bëjmë me familjen Abazi. Ka pasur edhe më parë kërkesa nga disa familje të fshatit Celinë që të bëhet zgjerimi i rrjetit të kanalizimit sepse është shumë e nevojshme. Tek disa familje që janë me shtëpi afér familjes Abazi ju është rregulluar problemi i kanalizimit, kurse familjes Abazi jo, arsyen nuk e di pse nuk ju është kryer, nuk dua askënd ta akuzoj. Por i kisha propozu drejtorit të Shërbimeve Publike që të merë hapa konkrete që familjes së Fikret Abazit dhe vëllezërve të tij të i gjejë një zgjidhje sa i përket kanalizimit, kjo familje edhe ekonomikisht nuk qëndron mirë dhe e meritojnë që të kenë kanalizime, sepse është edhe prioritet zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, temën për të cilën do të bisedoj unë është e njëjtë me parafolësin, ka të bëjë po ashtu me çështjen e kanalizimit, ku ka qenë një projekt për rrjetin e kanalizimit në fshatin Zoishtë, konkretisht ka të bëjë me rrugën “7 Shtatori”. Në këtë rrugë graviton një

lagje goxha e madhe, qytetarët e kësaj pjese kanë ankesa se rrjeti është kryer, por është kryer në mënyrë jo cilësore. Pusetat qysh tani kanë filluar me u plasarit, pra cilësia nuk është në nivel, nuk e di a ka pasur organe mbikëqyrës komuna apo jo, po ashtu edhe rruga ku është ndërtuar ky rrjetë nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme. Mendoj se komuna duhet të merë përgjegjësi për këtë pjesë të projektit që nuk është aspak në nivelin e duhur.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, të nderuar kërkoi një sqarim nga ekzekutivi, shoqatës Anadrinia Jehonë ju janë ndarë vetëm 500.00 €, nuk e di se si munden me dalë të suksesshëm këta anëtarë të kësaj shoqate kur nuk kanë mjete të mjaftueshme, kurse këshillit organizativ të festivalit Anadrinia Jehonë ju janë ndarë 3.500 €. Me duket tepër e pa arsyeshme të ketë një dallim kaq i madh, nuk dua një përgjigje nga kryetari i Komunës që të thotë se ky nuk është problem i komunës ose i kuvendorit, ne i kemi nënshkruar 5,500.00 € për dreka, darka dhe organizime të ndryshme, që për mua këto janë vetëm humbje. Për mua asgjë nuk është korrrupsioni sepse nëse vjedhë me ty merren organet kompetente dhe hynë në burg, por ne i kemi dhënë me duart tona 5,500.00 € kurse shoqatës Anadrinia Jehon i jepen vetëm 500.00 €, a është arsyaja pse këtë shoqatë e udhëheq një njeri që nuk e dëshironi ju apo si qëndron puna, ose dëshironi politikisht ta dëmtoni këtë organizatë.

TraJKO Shariq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha ta paraqesë para juve një problem të cilin e kemi në lagjen e epërmë sa i përket deponive të egra, kjo deponi gjendet tek fusha e sportit në lagjen e epërmë të Rahovecit, kjo fushë shfrytëzohet nga të rinjtë e kësaj lagje, por kjo deponi është duke ja u rrezikuar shëndetin atyre. Sa e di projekti për eliminimin e këtyre deponive ekziston në Drejtorin e Urbanizmit, sa është mundësia që nga investimet kapitale që janë pranë zyrës komunale për kthim dhe komunitete, ato mjete të shfrytëzohen për eliminimin e kësaj deponie.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shqetësimi imë është sa i përket lokaleve të natës dhe lojërat e fatit, ne e dimë se është aprovuar një ligje që i ky mbyllur këto lokale plotësisht, por ka ankesa nga qytetarët e shumtë se këto lokale janë duke funksionuar ende në mënyrë ilegale. Mundë të thuhet se fëmijët tanë përsëri janë duke u atakuuar me këto gjëra negative, ne si shembull konkret mundemi ta marrim Komunën e Istogut dhe Klinës, të cilët hiq më larg se dje inspektorati i këtyre dy komunave ka dele në teren për ti inspektuar se janë të mbyllura këto lokale, dhe nëse po janë mbyllur nga njerëz kompetent.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të bëjë një pyetje ku besoj se të gjithëve i intereson, pyetje ime është: Si është gjendja e Stacionit të Autobusëve Rahovec, komisioni i cili është formuar nga kuvendi e ka kryer punën i ka zgjedhë anëtarët e bordit të kësaj ndërmarrje. Prandaj pos kësaj a është kryer ndonjë punë tjetër, dhe besoj se duhet që të angazhohemi më shumë në këtë drejtim dhe të i japim fund një herë e mirë problemeve të kësaj ndërmarrje.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ashtu edhe unë desha të ngrisë një shqetësim sa i përket rrjetit të kanalizimit, është një pjesë në fshatin Fortesë ku kanalizimi i cili përçon përmes lumit ka mare një plasari, dhe komplekt ujërat e zeza nga ky kanalizim derdhen në shtratin e këtij lumi. Kërkesa e qytetarëve është që të ndërmerren masat në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik. Pastaj edhe në mbledhje të kaluara e kemi ngritur si çështje raportet e drejtorive, të cilat duhet të na vinë në kuvend në baza 4 mujore ose 6 mujore. Në këtë vite në përjashtim të Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Urbanizmit të cilët na kanë sjellë nga një raport, drejtoritë tjerë nuk kanë ndonjë iniciativë për raportim në kuvend. Në gjatë hartimit të planit e kemi mbajtur një punëtori me OSBE-në, ku na kanë sugjeruar që kishte me qenë shumë transparente që drejtoritë më të rëndësishme të na raportojnë së paku në baza gjashtë mujore. Nëse janë pro këtij sugjerimi pse nuk e kanë sjellë ndonjë raporte, nëse jo atëherë cila është arsyaja që nuk po i sjellin raportet.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, shqetësimet të cilat u ngriten nga ana e juaj janë me vend, por unë do i japë përgjigje atyre pyetjeve të cilat lidhën ndoshta drejtpërsëdrejtë me mua, tjerat përgjigje do ju jasin drejtorët kompetent. E nderuara znj. Thaqi, ne në thirrjen publike për shpërndarjen e subvencioneve për herë të parë i kemi përfshi edhe subjektet e organizuara dhe personat fizik. Ka qenë një komision i cili është formuar për ndarjen e subvencioneve në bazë të një programi ose projekti ku ata kanë

aplikuar. Sa i takon “SHKA – Anadrini” kjo shoqatë nuk është pjesë e festivalit “Anadrinia Jehon”, nuk ka qenë as në vitin e kaluar e as këtë vit, e nderuar asnjë aktivitet për festivalin “Anadrinia Jehon” nuk e bënë shoqata “Anadrini”. Falënderoj kuvendin e komunë që i ka ndarë mjetet edhe vitin e kaluar por edhe këtë vit specifikisht të dedikuara për organizimin, mbarëvajtjen dhe përfundimin e suksesshëm të festivalit “Anadrinia Jehon”. Shoqatën Anadrini e udhëheqë vetëm një njeri të cilin e kam ma mikë se dikush që mundet të ngrisë një çështje të tillë në Kuvendin e Komunës, por nëse doni të flasim për korrupsion, ju lutem po shkojmë me rend edhe ato 2,000.00 € që ja kemi dhënë Anadrinit edhe në emrin time por edhe në emrin tuaj, pra të shkojmë se ku i kanë shpenzuar këto mjete. Pastaj do të shkojmë se ku kanë shkuar edhe 3,000.00 € që i kanë marr në emër të festivalit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, po flasë edhe si Smajl Latfi edhe si Kryetar i Komunës, kur në jetën time nuk jam korruptuar, nëse është i interesuar ta ngrisë dikush këtë çështje atëherë unë jam i detyruar të i dërgoj letër Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit se ku shkuauan 3,000.00 € dhe pse nuk ju dedikuani festivalit “Anadrinia Jehon”, pse këto mjete nuk ju kanë dedikuar ngjarjes e cila ka ndodhur në vitin 2018. Unë kam vendosur me i nda shoqatës “Anadrini” këtë vite 500.00 € dhe besoni se edhe këto më duken shumë, prandaj kush ngritë këso shqetësimë, shyqyr zotit e kemi policin dhe prokurorin dhe të jeni i sigurte që unë jam i gatshëm vetëm urdhëroni. Të nderuar 5,500.00 € i ka mare nga komuna festivali “Anadrinia Jehon”, ku kanë marr pjesë shumë anëtarë të kuvendit sepse kjo është një ngjarje e madhe për Komunën tonë, po ashtu besoj se këto nuk janë harxhuar për dreka dhe darka, ju mundeni të shikonit specifikacionin aty ceket shumë mirë se për çka janë harxhuar. Kurse sa i përket raportimit, secili përfitues nënshkruan marrëveshja me Kryetarin e Komunës, pastaj ata janë të obliguar që të sjellin raporte të shkruar, përkitazi me arsyetimin e shpenzimeve të bëra. Sa i takon performancës ne si komunë jemi mirë, e kemi përfituar grandin e performancës nga Qeveria e republikës së Kosovës, jemi përzgjedh si komuna e katërt në republikën e Kosovës, ku dje në është konfirmuar shuma prej 60,000.00 € nga MAPL-ja që na takon neve si komunë. Po ashtu jemi edhe ndër komunat më transparente, kemi mbërritur një nivel bukur të lartë të pikave dhe kjo është falë rezultatit të punës suaj të përbashkët. Deri më tani as unë dhe asnjë zyrtarë nga komuna e Rahovecit nuk ka pasur ndonjë intervistomë nga policia për krimet të rënda, urojmë që kjo polici të mos ketë nevojë të vije në komunën tonë. Po ashtu në raportin e auditimit kombëtar jemi shpallur komuna me opinion të pamodifikuar, kjo do të ndikojë drejtë në rrjetjen e fuqisë absorbuese për përfitimet të ndonjë grandi ose ndonjë donacion, qoftë nga qeveria qendrore ose nga jashtë. Kurse sa i përket pyetjes së z. Ali Zhuniqi, i nderuar Kryetari i Komunës sipas ligjit është i obliguar që dy herë në vite të sjellë në kuvendin e komunës raportin, pra një herë për 6 mujorin e parë, dhe 6 mujorin e dytë. Shpresojmë në muajin Korrik ose Gushtë do ta kemi raportin 6 mujor ku do të përfshihen të gjitha drejtorit e komunës dhe sektorët që ndërlidhen me ekzekutivin e komunës.

Përparim Krasniqi – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Fazliu jam i njoftuar me atë problem në fashitin Celinë, ne e kemi mare përsipër që ta kryejmë kësaj familje ato 70 metra që i kanë mbetur. Arsyesa pse ka mbetur pa përfunduar është sepse duhet të kalojë gypi përmes disa oborreve private. Kurse sa i përket pyetjes së z. Cena, i nderuar ju njoftoj zyrtarisht se punimet janë shumë cilësore, puseta është dëmtuar nga një kamion i transportit të rëndë. I nderuari z. Shariq ne kemi filluar një projekt për trajtimin dhe eliminimin e të gjitha mbeturinave në gjithë komunën e Rahovecit, shpresojmë shumë shpejtë të vijmë në rrugën “Bekim Isma” ku do të eliminojmë të gjitha ato mbeturina. E nderuara znj. Hanalora pyeti rrëth çështjes së stacionit të autobusëve, ajo ka qenë së bashku me mua dhe z. Rexhep Oruçin anëtare e komisionit, ne kemi punuar në këtë drejtim, tani jemi në fazën ku do të zgjidhet edhe kryeshefi ekzekutiv. Besoj se në muajin korrik ne do të bëjmë një raport në bashkëpunim me juve rrëth ecurisë së punëve në stacionin e autobusëve. Kurse sa i përket pyetjes së z. Zhuniqi, i nderuar për një pjesë e lagjes kemi planifikuar që të ndërtojmë rrjetin e ri të kanalizimit, janë diku 3 segmente, kanalizimi ekzistues është vendosur më herët dhe për momentin është jashtë funksionit. Pra kjo lagje do të ketë shkëputje, nuk do të derdhet në lumë kanalizimi por do të shkojë drejtë në kolektorin kryesor ku do të vendoset. Unë tu përgjigja për pjesën që është nën kompetencën time, kurse sa i përket pjesës së lumit do ju përgjigjet Drejtori i Urbanizmit sepse është nën kompetencën e tij.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, shqetësimi imë është rreth shenjëzimit të rrugëve në nivel komunal si dhe mungesa e tabelave afér shkollave të cilët janë një orientim dhe informim. Mendoj se kishte me qenë mirë që rrugët që janë afér shkollës të vendosen disa pengesa sikurse që janë vendosur tek palestra e sporteve, ku do të lejohet edhe kalimi i këmbësoreve posaçërisht fëmijët, sepse ata janë gjithmonë të kërcënuar nga komunikacioni. Po ashtu kam një kërkesë për ju që: Të gjitha ato shoqata që përfitojnë mjete nga Komuna të na sjellin një raport sa i përket destinimit të mjeteve të mara nga komuna, sepse metë vërtet ekzistojnë disa shoqata në komunën tonë që janë funksionale vetëm në letër. Nuk e besoj në komunën tonë që ka më shumë se 15 shoqata funksionale, kurse tjerat janë vetëm në letër, ku pastaj përfitojnë mjete dhe ato mjete shkojnë për individë të caktuar. Prandaj për këtë duhet të ketë edhe llogaridhënie ligjore sepse ka shoqata që janë funksionale dhe kanë nevojë për mjete, kurse këta jo aktive përfitojnë pa pasur nevojë.

Fehmi Cena – Nuk pajtohem me atë që e tha Drejtori i Shërbimeve Publike se janë kryer punimet në mënyrë cilësore, ai e prezantoi pusetën, një pusetë qe cila është e shkatërruar pothuajse tërësisht ku ka kaluar kamioni mbi të, shtrohet pyetje: A duhet të i rezistroj kamionit puseta apo vetëm këmbësorëve. Pastaj nuk është vetëm ajo pusetë, por ju lutem shkonit dhe shikonit asnjë pusetë nuk është e pa plasaritur, pra punimet nuk janë aspak cilësore. Pastaj siç e ceka rikthimi i rrugës në gjendjen e mëparshme nuk është bërë, banorët po kanë probleme të kalojnë në këto rrugë, ju mundeni të i pyetni banorët se a janë cilësore punimet dhe a i shërben ajo rrugë sikurse më parë apo jo.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin dhe pyetjet e bërë në pikën e dytë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave dhe KAB-it 2020-2022.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, me datë 17.05.2019 në adresë të Drejtorisë së Financave ka arritur qarkorja e parë buxhetore, pa limite dhe tavane buxhetore, por si tërësi e buxhetit për komunën tonë. Në qarkoren e parë buxhetore nuk i kemi kufijtë buxhetor, kategoritë ekonomike, pozicioni e pagave, mallra dhe shërbime, investime kapitale etj. Por është si pjesë e buxhetit të komunës Grandi i Arsimit, grandi i shëndetësisë dhe grandi i administratës, ju e dini se në muajin shtator do të rregullohet edhe versioni i KAB-it final, ku do të aprovohet nga ju. Buxheti për Komunën e Rahovecit për vitin 2020 do të jetë në shumën prej 14,735,819.00 €, grandi i përgjithshëm do të jetë 5,843,000.00 €, nëse e bëjmë një krahasim në raporte me vitin e kaluar, do të shohim se kemi një rritje prej 612,000.00 €. Grandi për Këshillin e Hoçës së Madhe është 24,904.00 €, ka një ndryshim pozitiv prej 1,410.00 €, grandi për shëndetësi është 1,889,703.00 €, me një ndryshim pozitiv prej 101,463.00 €. Në bazë të formulës që duhet të llogaritet buxheti për shëndetësi ka rrjedhë një gabim, ku ne jemi të dëmtuar në shumën prej 29,000.00 €, por ne në afatin e rregullt kohorë do të adresojmë kërkesat në Ministrinë e Financave ku shpresojmë se do të rregullohet ky problem. Te arsimi kemi një grand prej 5,820,978.00 €, ku ka një ndryshim pozitiv prej 4,440.00 €, pra në total grandi është në shumën prej 13,578,973.00 €, që është një ndryshim pozitiv në total prej 1,155,469.00 €. Të[hyrat vetanake i kemi në shumën prej 1,156,841.00 €, ka një rrënje në raport me vitin e kaluar në shumën prej 11,926.00 €. Në qarkoren e parë buxhetore mungon edhe huamarrija që gjithsesi shpresoj se do të kemi në qarkoren e dytë buxhetore, nëse e nisemi me krahasimin nga viti i kaluar, në total huamarrija është në shumën prej 168,615.000 €, sigurisht se buxheti do të ritet në vlerë prej 14,735,000.00 €.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i9 nderuar drejtor sa është buxheti i komunës për vitin 2020, a është rritur apo zvogëluar në krahasim me buxhetin e viti 2019, pastaj ka do të orientohet ky buxhet, në paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunale, subvencione, apo shpenzime kapitale.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, në faqe nr. 6 tek synimet pika 5 përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, pika e 6 shkruan: Hartimi i planeve zhvillimore dhe urbane, në bazë të ligjit të ri të planifikimit hapësinorë nuk ekzistojnë më planet urbane, këto kanë qenë të parapara me ligjet e vjetra. Prandaj këtu duhet të shkruhet Hartimi i planit zhvillimore komunal dhe Hartës zonale, këto janë dy

dokumente bazë mbi të cilat duhet të punohet. Pastaj tek synimet për të ardhmen tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, mendoj se duhet të shtohet edhe krijimi i hapësirës për galerinë e arteve, e kemi ne një hapësirë në qendrën kulturore në katin e tretë, por ajo me të vërtet nuk është e përshtatshme, aty ku është biblioteka të zvogëlohet një hapësirë dhe të krijohet vendi për galerinë e arteve për të ardhmen. Kalojmë tek KAB-i, në faqe nr.10 tek të hyrat, jam duke parë që në Drejtorin e Urbanizmit paska taksë për shfrytëzimin e pronës publike, pastaj e njëjtë taksë ekziston edhe në Drejtorin e Shërbimeve Publike taksë për shfrytëzimin e pronës publike, jam duke parë që në vitin 2020 kjo taksë është duke u larguar nga Drejtoria e Urbanizmit sepse ka qenë gabim dhe kjo është shumë pozitive. Kurse tek të hyrat taksa për legalizimin e objekteve pa leje, ligji për legalizimin e objekteve pa leje ka hyrë në fuqi, pritet të hyjë edhe udhëzimi administrativ, deri në vitin 2020 nuk parashihen fare të hyrat e legalizimit të hyrave pa leje, mendoj se duhet të parashihen të hyrat. Në Komunën e Rahovecit janë diku rrëth 14864 objekte pa leje, me ligjin e ri për legalizim taksa është $1m^2$ për banim dhe $2m^2$ për afarizëm. Do të bëhet legalizimi i të gjitha objekteve përpos atyre që janë të ndërtuara në pronën komunale dhe në komasacion, por në komasacion do të hynë në listën rezervë shtetërorë, e jo në listën e rrënimit që aktualisht është, por edhe ato që janë në listën e rrënimit, ato objekte do i rrënojë qeveria qendrore e jo komuna.

Fahrije Lushi – Morina – Të nderuar do të ndërlidhem me diskutimin tim që e kam bërë në KPF, sa është motivuese dhe inkurajuese rekomandimi që na ka ardhur në MASHT-i rrëth, ku ju rekomandohet drejtorive komunale të arsimit nëpër komuna që mos të hapin konkurse të reja për ato vende që mësimdhënësit kalojnë në pensionim, por ato orë të ju shpërndahan mësimdhënësve të cilët kanë mangësi të orëve. Si e arsyetoni ju këtë rekomandim të MASHT-it, sa është inkurajuese kjo për ata që presin të diplomojnë.

Rasim Fazliu – Desha të diskutoj për disa çështje sa i përket kësaj pike, në faqe nr.5 tek objektivat, ceket këtu hapja e tregjeve të reja në Komunën e Rahovecit, si dhe funksionalizimi i tregjeve ku janë cekur si Krushë të Madhe, Ratkoc etj. Mua më intereson ta di se ku është ky treg në Krushe Të Madhe, sepse unë jam aty afër dhe nuk e di këtë lokacion, a ka hapësirë në Krushe të Madhe që është e dedikuar vetëm për treg, a ka qenë funksionale ky treg dhe nësse po kur është shuar ky treg. Sa e di unë tregu në Krushe është nëpër rrugë, por treg të veçantë nuk e di që ka. Në faqe nr. 9 ajo që më interesoj mua janë planifikimi për të hyrat vetanake, është interesante se planifikimi i të hyrave vetanake është më i vogël karshi viteve paraprake, ne e dimë që viteve të kaluara të hyrat vetaneke kanë qenë deri në 1,600,000.00 €, por ne asnjëherë nuk kemi mundur me i realizu këto të hyra, gjithmonë kemi mbërritur deri në 1,000,000.00 €. Tani pasi janë shtuar disa taksa sikurse tatimi për tokë, pastaj taksa për mbeturina, është krejt problem tjetër që komuna nuk po mundet me gjete zgjidhjen për mbledhjen e taksës për mbeturina, mendoj se planifikimi është dashur tani të jetë më i madhe se sa në vitet paraprake. Pastaj tek disa prioritete që janë dhënë tek ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, pastaj ndërtimi i kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet, është shumë në rregull sepse komuna jonë ka shumë nevoja ku ndoshta buxheti i komunës nuk ka mundësi të i mbulojë të gjitha. Kishte me qenë mirë që kur të përgatitet KAB-i final, të ndahen mjetet për të gjitha kategoritë ekonomike dhe për të gjitha sektorët, por fokusimi më i madhe kishte me qenë mirë të jetë në rrugë fushore, pa i lënë anash edhe ujin e pijes dhe kanalizimet. Tek investimet kapitale e pashë që ka pak rënje, pyetje ime për drejtorin është pse ka ardhur deri tek kjo për minus 3.73%, ne e dimë një përgjigje që thuhet se gjobat nga gjykatat dhe trafikut do të planifikohen nga niveli qendrorë, por është mirë që të na jepe një përgjigje drejtori. Është shumë mirë që nga viti në vite edhe qeverisjet janë duke u zhvilluar me disa përparime që janë duke i bërë gjatë propozimeve që janë duke i dhënë për KAB, ju e dini shumë mirë që viteve paraprake kemi pasur probleme të shumta rrëth asaj që kanë qenë të kanalizuar gabimisht mjetet, pe marr për shembull shpenzimet e varrimit ku është dashur të paguhen nga subvencionet e kryetarit, kurse tani është bërë shumë mirë që janë ndarë nga mallrat dhe shërbimet. Në faqe nr.10 i kemi të hyrat nga shitja e mbeturinave, paraprakisht bisedova me drejtorin, prandaj mendoj se kishte me qenë mirë që të përmirësoset sepse ne shitje të mbeturinave nuk kemi.

Ali Zhuniqi – Desha të diskutoj rrëth pikës së katërt sa i përket përmirësimit të shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve, e kemi njërin ndër pikët e cila mënoj se është zakonisht e ndjeshme si kujdesi paliativë dhe

kujdesi shtëpiak e di që është një grupe i infermierëve në kuadër të Caritasit i cili funksionon për shërbime palliative, por nuk e di se sa është aktivë, në Suharekë e di që është shumë aktiv. Një pjesë e qytetarëve e di që kanë shumë nevojë për këtë përkujdesje, kisha pas dëshirë që pak më shumë të kemi informata rrëth kësaj pike, edhe pse kjo i takon më shumë Drejtorisë së Shëndetësisë. Kurse tek faqe nr.11, vitin e kaluar kur na ka ardhur ky material konkretisht jam ndalur tek politikat e reja, tash jemi duke parë që ministria i ka dhënë disa rekomandime që nga viti 2020 – 2022, ku sugjeroni që grandi i përgjithshëm i komunave nga 10% të bie në 8%. Na kanë ardhur 4 rekomandime ku në njëren prej rekomandimeve thotë se komuna nuk ka informata të nevojshme për të bërë analizimin e inpaktit të kësaj politike, a është e vetëdijshme komuna dhe kryetari dhe a kanë mare masa që në të ardhmen politikat qoftë afatmesme apo afatgjate, grandet qeveritare për komunat do të bien. Cilat janë politikat që në të ardhmen të ngritën të ardhmet qoftë nga tatimi në pronë, qoftë nga bizneset në mënyrë që ky buxhet të mbahet në këtë linjë që është deri më tanë.

Fehmi Cena – Kur jemi tek qarkorja e këtij viti jemi duke parë që ka disa risi në krahasim me vitin e kaluar, drejtori e ceku që ka rritje të buxhetit nga grandi qendrorë, i përgjithshëm dhe për grandin specifik për shëndetësi dhe arsim. Kur jemi tek ky diskutim a kam një pyetje sepse tek pagat dhe mëditje janë duke u përmendur më tepër ngritjet për arsyet të shtimit të numrit të punëtorëve, apo për shkak të ngritisës së pagave në disa sektorë, me vendim të nivelit qendrorë. Pyetje ime është a përkon kjo shumë me këtë ngritje, a është marr parasysh kjo sidomos për vitin 2020 kur të përgatitet KAB-i, ne duhet të dimë si këshilltar, ne e dimë se rritja e pagave do të hyjë në fuqi tek ka fundi i vitit. Pastaj të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe nga policia tani do të barten në nivel qendrorë, prandaj është një arsyetim këtu se të hyrat vetanake komunale do të shënojnë një ulje. Pastaj përmendet se në sektorin e arsimit pas pensionimit pagesa e tre pagave për punëtorët e arsimit, por nuk është duke u cekur kjo edhe për punëtorët e shëndetësisë, nga kryetari është thënë se kjo vlen edhe për shëndetësi por unë këtu nuk jam duke parë që është cekur diku. Po ashtu edhe unë nuk pajtohem që të hyrat vetanake për vitin e ardhshëm të shënojnë rënje, është e vërtet se të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe trafikut nuk do të hynë në kuadër të të hyrave komunale, por duke mare parasysh disa tarifa të tjera si tatimi në tokë që do të jetë, nuk e mendoj që do të duhej të jetë buxheti më i vogël, por do të duhej të jetë rritja e buxhetit. Mos është kjo ideja e qeverisë komunale që të planifikojë të hyrat më të vogla, ku pastaj ata do ti tejkalojnë të hyrat dhe të bëjnë lëvdata se kemi realizuar më shumë të hyra se që i kemi planifikuar, kjo duhet nga tani të mendohet sepse nga aty bëhet vlerësimi. Do isha ndalur pakë tek shëndetësia, u përmend pika e shtatë kujdesi palliativë kujdesi shtëpiak, kjo ka qenë edhe për vitin 2019, por ky shërbime nuk ekziston, në fillim të vitit 2018 ka ekzistuar ky shërbim i cili e ka kryer një punë shumë të mirë në teren, sepse ne kemi një pjesë të pacientëve të cilët nuk kanë mundësi fizike që të vijnë deri tek shtëpia e shëndetit dhe këta pacientë kanë nevojë për ofrim të shërbimeve në shtëpitë e tyre. Është mirë që këtë shërbim drejtoria ta aktivizojë sepse janë pranuar mjaftë punëtor edhe përmes Caritasit edhe si të rregullt, prandaj nga ta mundën të formohen ekipet që të dalin në teren dhe të i kryejnë këto shërbime qytetarëve që janë shumë të domosdoshme. Pastaj është edhe një pikë ku ceket. Rehabilitimi i pacientit me sëmundje mentale, komuna jonë ka goxha me këto sëmundje, por kanë mbetur pa mbështetje institucionale, nuk e di se në çfarë mënyre tani ka menduar drejtori të i mbështesë. Ne e kemi përmendur edhe më parë që komuna ka të drejtë të e ndërtojë një qendër shëndetësore për qëndrim ditor, pikërisht për këta persona që në komunën tonë janë rrëth 300, ku atyre do të ishte mirë të ju ofrohet shërbimi dhe rehabilitimi. E kemi cekur gjithashtu se kishte me qenë mirë që ti sigurohen edhe barnat në mënyrë permanente, është premtuar por asgjë nuk u realizua dhe këta të sëmurë janë duke vazduhar vetë të i blejnë këto barna gjë që nuk është mirë. Mendoj se kishte me qenë më urgjente që barbat të i sigurohen këtyre pacienteve, kurse sa i përket objektit kjo mundet të përfshihet në kornizën afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme. Jam duke parë që në shëndetësi do të ketë të hyra më pak për vitin 2020-2022, nuk e di ku është bazuar drejtori, por mendoj se duhet të gjenden format sepse ka mundësi që të krijohen më shumë të hyra në shëndetësi.

Rukije Krasniqi – Kam për të diskutuar për disa specifika rrëth grandeve shtesë të financimit nga ministria për kriteret të cilat janë përdorur, mundoj se ministri i financave ka takim e me drejtorët e financave në nivel komune. Mendoj se duhet të bëhet kategorizimi i kritereve në nivele rajonale për nxënës nëpër shkolla dhe

buxheti të cilët alukohet për nivele komunale, nuk duhet të krahasohen komunat e zhvilluar siç është Prizreni, Prishtina dhe shumë komuna tjera me Rahovec ose me Deçanin dhe Junikun, dhe të dërgohen mjetet financiare në mënyrë të barabartë. Që nga historia e ish Jugosllavisë dhe alokimi i mjeteve atë kohë është ndarë në bazë të komunave të pa zhvilluara, ku ju janë dhënë mjetet më shumë këtyre komunave në formë ndihme. Nëse nisemi me kriterin e mjeteve të ndara në kokë të nxënësit në qendra lokale atëherë, mendoj që është një farë lloj diskriminimi, sepse nëse shihet edhe proporcioni i nxënësve me mësimdhënës është shumë i lartë, nuk mundet të jetë në at vise ki ka emigrime më shumë, në disa qytete ka emigrime më tepër dhe është dukshëm rrënje e nxënësve në nivele komunale në shkollat tona. Raporti i nxënësit me mësimdhënës me qenë 1.21 me 3 është tepër i lartë, kjo i bie që klasat të mbyllen dhe të dalin mësimdhënës nga puna, kjo është përgjigje që e kërkoi kolegia se çfarë do të ndodhë me ata mësimdhënës që do ti marrin orët shtesë, dhe mos hapja e vendeve të reje të punës. Mendoj se kategorizimet e niveleve nuk duhet të jenë të njëjtë në nivel Kosove, jam e vetëdijshme që ne nuk mundemi të ndryshojmë këtë, por ky është një opinion i imë si mësimdhënëse dhe i jetës aktuale në Kosovë dhe në komunën tonë, dhe duke i parë specifikat e vendit tim, prandaj mendoj se duhet të përkrahen më shumë nga ministria vendet më pak të zhvilluara. Ky shqetësim lidhet direkët me MASHT-in dhe MF, tek kriteri i ndarjes së mjeteve për kokë nxënësi dhe numri i nxënësve për një mësimdhënës është de – facto jo në rregull. E sugjeroi drejtorin e financave kur të mbajnë takime me ministrin e financave të ja përcjellin këto shqetësimë.

Afrim Limani – Ju faleminderit të gjithëve për pyetjet e parashtruara, i nderuar z. Masar Popaj, kemi një rritje të buxhetit në 8.48%, pra një buxhet në rritje prej 1,155,000.00 €, ky buxhet sipas analizave dhe parashikimeve tona do të pozicionohet në pozicionin e pagave 13.30 %, kurse përmallra dhe shërbime do të jetë 8.68%. Por ne jemi duke e pritur edhe versionin final të qarkores së dytë buxhetore dhe aty do të parashihen saktë limitet apo tavanet buxhetore. Kjo rritje në pozicionin e pagave është kryesisht për arsyet e hyrjes në fuqi të ligjit të ri mbi paga. Pajtohem po ashtu me shqetësimet që i parashtro z. Cena, do ti kemi parasysh të gjitha për qarkoren e dytë buxhetore, sa i përket taksës për legalizimin e objekteve që do të hyjë në fuqi të ju them të drejtën nuk kam asnjë informatë për këtë, do interesohem rrëth kësaj dhe në planifikimin final të buxhetit do ta përfshi edhe këtë taksë. E nderuara znj. Lushi është shumë e vërtet që MASHT-i është duke i toleruar disa gjëra dhe duhet të mirëkuptohen, sigurisht që edhe ne si organizatë buxhetore do ta kemi një buxhet më të vogël në arsim në proporcione numrin e mësimdhënësve, sipas kësaj qarkore ne sipas analizave tona diku rrëth 26 mësimdhënës do të mbeten pa punë. I nderuari z. Fazliu tregjet të cilat janë në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë është faktë se janë në planin strategjik të kësaj drejtorie që të ndërtohen edhe 3 tregje të reja, një në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc. Sa i përket të hyrave i nderuar limitet i cakton MF, dhe disa lloje të të hyrave tjera na vinë limitet nga MF, të hyrat për Komunën e Rahovecit për vitin 2020, të hyrat tatimore do të ngritën, ndoshta ne do të kemi problem që ti realizojmë këto të hyra, të hyrat nga tatimi në tokë janë dyfishuar, ndoshta në fazën e parë të implementimit do ta kemi edhe problem që të realizojmë. Por në anën e kundërt të hyrat jo tatimore kanë një zvogëlim të dukshëm, ku jam detyruar që të zvogëloj disa të hyra sepse tavani është shumë i ulët, prandaj jam detyruar që të shkoj me një rrënje për të gjitha llojet taksave. I nderuar z. Zhuniqi i pranojë rekomandimet tuaja do konsultohem me drejtorin e shëndetësisë, besoj se në qarkoren e dytë buxhetore do të kihen parasysh rekomandime e juaja. Kurse sa i përket politikave ekonomike të Komunës së Rahovecit të cilat nga 10% kanë rënë në 8%, i nderuar në kuadër të MF ekziston një departament i cili merret me politikat zhvillimore ekonomike, po ashtu edhe buxheti i republikës së Kosovës është si rezultat i analizave dhe strategjive të tyre së bashku me Bankën Botërore. Buxheti prej 10% në kuadër të 2 milionëshit që ndahet për komuna, ka disa vite që ka tendencia që ky buxhet nga 10% të zbritet në 8%, deri më tanë ende nuk është bërë, shpresojmë që nuk do të bëhet asnjëherë, sepse me këtë komunat do të kenë -2% buxhetin me të vogël. I nderuari z. Cena 13.5% e buxhetit do të orientohet në pozicionin e pagave duke e ditur se që nga viti 2020 do të filloj së aplikuar ligji i ri për paga. Sa i përket 3 pagave jubilare, i nderuar arsimi e ka formulën e vetë për llogaritjen e buxhetit, po ashtu edhe shëndetësia e ka, por në kuadër të shëndetësisë nuk ka paga jubilare, kjo nuk është e përcaktuar ende me ligj. E nderuara znj. Krasniqi pajtohem me të gjitha ato që i the, ne nivel komunal

asgjë nuk mundemi të ndryshojmë, shqetësimet e juaja është dashur të i ngrisë ndonjë deputet i kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse këto ndryshime bëhen vetëm përmes kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar, e qes në votim Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave dhe KAB-it 2020-2022: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dalje në debat publik të Draft Rregullores Komunale për Transparencë.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kjo rregulllore është hartuar nga një grup punues, ne e kemi pas këtë rregulllore në mars 2016 është votuar në këtë kuvend, por pas ndryshimit të udhëzimit administrative kemi qenë të detyruar që ta bëjmë ndryshimin e kësaj rregulllore. Ju të nderuar në këtë mbledhje vetëm do të merrni vendim për dalje në debat publik, kurse pas debatit publik kjo rregulllore do të vijë përsëri në kuvend për shqyrtim dhe aprovim.

Kryesuesi – Pasi nuk ka askush të diskutoj diçka sa i përket kësaj rregulllore, e qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për dalje në debat publik të Draft Rregullores Komunale për Transparencë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Informatës mbi Raportin e Performancës komunale janar – dhjetor -2018.

Bjondina Rama, koordinatore për vlerësimin e performancës së komunës – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, edhe pse të gjithë e keni para vete raportin, dua që në pikë të shkurtata të ju informoj se çka do të thotë performance. Ne jemi një komision i formuar me vendim nga kryetari i komunës, ku raportojmë për punët tonë për çdo vit, ne për këtë vite jemi përfitues të performancës, jemi në mesin e 4 komunave më të mira në Kosovë, mendoj që ka pas përmirësimë, ka nevojë ende për përmirësimë. Performance është grumbullim i të gjitha të dhënavë të analizuara gjatë një viti të raportimit për 64 fusha ose indikatorë, me përformacë mundemi të themi se të gjitha drejtoretë përvrësh shëndetësia dhe arsimi që nuk janë të përfshirë të gjitha të tjerët po. Jemi duke punuar që të jemi në vendet e para, performance është një instrument që i matë të gjitha punët që kryhen në komunë duke mare parasysh shërbimet publike administrative, transparenca, kultura, rinia dhe sporti, e drejta e njeriut dhe shërbimet sociale, transporti publik komunal, hapësira për parkingje publike, furnizimi me ujë të pijes, kanalizimi, hapësira publike komunale, infrastruktura lokale, menaxhimi i fatkeqësive, menaxhimi i mbeturinave dhe mbrojtje e mjedisit. Për të gjitha këto fusha janë të cekura në raport, për çdo pyetje që e bëni ne jemi këtu për të ju përgjigjur juve.

Kryetari – E nderuar znj. Bjondina e paraqiti një informatë sa i përket performancës, besoj se është një arritje për komunën e Rahovecit sepse ka një ngritje, por unë edhe me këtë nuk jam i kënaqur edhe pse në vitin 2017 komuna jonë ka qenë me renditje në vendin e 26, por edhe me vendin e 4 nuk jam i kënaqur sepse ka mundësi që ne në disa aspekte nuk i kemi kushtuar aq sa duhet vëmendje. Nëse i shohim ne ku na janë dhënë vërejtjet, nëse do të kishim më shumë vëmendje ne sot do të kishim mundësin ta kemi edhe pozitën e parë, ne duhet të luftojmë që të kemi pozitën e parë. Ne jemi duke parë që Komuna e Junikut qe 3 vite e ka vendin e parë, por kjo komunë është shumë e vogël, i ka vetëm 3 fshatra më duket, pastaj Hani i Elezit është po ashtu në pozitën e 3 por ajo është një qytezë tepër e vogël dhe 2 ose 3 vendbanime të vogla. Ne do të luftojmë që për vitin 2019 të jemi në pozitën e parë, por ajo që më çudit është se diferenca në grante nuk është shumë e madhe, pra pozita e parë nga pozita jonë e ka diferençën vetëm 5,000.00 €. Pozita e parë i ka 65,000.00 € kurse pozita e 2,3,4 i kanë nga 60,000.00 €, pastaj pozitat tjera që vinë pas nesh nuk kanë ndonjë diferençë të madhe nga ne, prandaj më duke e pakuptimtë kjo, ndoshta është edhe ndonjë lojë e MAPL-së, sepse besoj se pozitës së parë i kanë takuar më shumë se 230,000.00 €, pastaj pozitës së 4 ku jemi ne i kanë takuar 170,000.00 €. Por si duke ata e kanë bërë një shpërndarje proporcionale që ti rehatojnë të gjitha komunat e kanë bërë këtë, por ne që jemi në vendet e para jemi goditur keq dhe kjo është gabim, këtë çështje ne që jemi në pozitat e para do ta ngrisim në MAPL, sepse nëse nuk ka ndonjë dallim nga pozitat e para me atë në pozitën e 15 atëherë ne nuk do ti japim shumë rëndësi dhe në fund e dimë se do të

marrim diçka. Por për me ardhur deri tek kjo pozitë ne e dimë se çka kanë hequr këta që kanë punuar me performancën nga unë.

Rasim Fazliu – Fillimisht ju uroj për vendin e katërt që e ka zënë komuna jonë, është mirë të tentohet që të shkohet nga vendi i parë, por nëse e lexojmë këtë raporte janë disa gjëra që cekën këtu që duhet të përmirësohen në vitet e ardhshme. Do të ndalem tek fusha e 6 ku është cekur planifikimi hapësinorë komunal, ne ende PZHK-në dhe HZ nuk e kemi, prandaj do të ishte mirë që të jemi më të shpejtë në mënyrë që edhe këto të i kemi dhe të dalim me performancë më mirë. Pastaj fusha 8 infrastruktura lokale, konkretisht tek menaxhim i mbeturinave, edhe pse ne qysh nga viti 2016 jemi munduar që të marrim në dorë menaxhimin i mbeturinave, por ende janë duke vazhduar të i mbledhin kompanitë ekzistuese, nëse komuna do i merrte ne menaxhim atëherë edhe komuna do të kishte të ardhura më të larta dhe do të kishim performancë më të lartë. Pastaj mbrojtja e mjedisit si fushë e fundit, ceket se komunës i mungon Plani Lokal i Mjedisit, prandaj është mirë që edhe kjo të bëhet.

Kryetari – Plani Lokal për Mbrojtje të Mjedisit është në procedurë dhe besoj se shumë shpejtë do të kryhet, është edhe kushte nga ministria, nëse nuk e kemi këtë plan do të kemi probleme në përfitim të grandeve në të ardhmen. PZHK-ja është në fazën e fundit dhe besoj se shumë shpejtë do të vije për aprovim në Kuvendin e Komunës, po ashtu edhe HZ është në proces, por nuk varet gjithçka nga ne, disa kërkesa që i parashtrroi z, Fazliu janë edhe sfida edhe qëllimet tona. Edhe unë jam pro asaj që të përshpejtohen disa veprime, në mënyrë që të përballen disa situata dhe të mos jenë më evidente në raportin e vitet të ardhshëm.

Fahrije Lushi Morina – Do të ndërlidhesha sa i përket asaj që e thamë që të luftojmë për vendin e parë, të nderuar do të ishte mirë që të përmirësohet edhe fusha e katërt, të drejtat e njeriut dhe shërbimet sociale. Kjo ka të bëjë me atë se sa mirët komuna me njerëz me aftësi të kufizuar, sa janë të rehabilituar dhe sa kanë përkujdesje. Po ashtu janë të raportuara me 0% duke filluar nga të punësuarit me aftësi të kufizuar, përkatësit gjinore, sa të punësuar nga komuniteti jo shumicë, sa janë gratë pjesëmarrëse në takime publike etj. pra do të ishte mirë që edhe kjo fushë të jetë më shumë e plotësuar, pastaj besoj se do të jemi në vendet e para.

Kryetari – Për performancë të qeverisjes së mirë dhe për barazi gjinore vendin e parë e ka zënë Komuna e Drenasit z. Ramiz Lladrovci, mbi gjysmën qeverisë e ka me gjininë femërore, pasta Qëndrim Kastrati nga Komuna e Kamenicës i dytë ka dalë sa i përket kësaj fushe. Ata nuk të pyesin se sa të gjinisë femërore i ke të punësuara në komunë, por sa janë në qeverisje, ne si komunë jemi me dy dhe nuk jemi shumë mirë. Po ashtu tek personat me aftësi të kufizuar nuk jemi mirë, mendojmë se do të mundemi të përmirësojmë këtë fushë të performancës.

Fehmi Cena – Pse nuk është i përfshirë arsimi dhe shëndetësia në raportin e performancës, a është pse është më vështirë për tu vlerësuar apo si qëndron puna.

Kryetari – Arsimi dhe shëndetësia janë dy sektorë të veçantë shumë të rëndësishëm, ata e kanë grandin specifik, besoj se janë mekanizmat e tjerë që merren me vlerësimin e tyre.

Kryesuesi – Kuvendar të nderuar ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12:10

01 Nr. 2047

Rahovec, 28.06.2019

Procesmbajtësi

Skender Hamza

